

VENDIM
Nr. 631, datë 29.7.2020

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 212, DATË 11.3.2020, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË
RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E OBJEKTEVE ARSIMORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pikat 1 dhe 2, të vendimit nr. 212, datë 11.3.2020, të Këshillit të Ministrave, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rindërtimit të objekteve arsimore (projektimin, zbatimin e punimeve, mbikëqyrjen dhe kolaudimin e këtyre objekteve) në vlerën, gjithsej, në masën 9 531 941 818 (nëntë miliardë e pesëqind e tridhjetë e një milionë e nëntëqind e dyzet e një mijë e tetëqind e tetëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, përkatësisht:

i. Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në vlerën, gjithsej, 4 347 753 223 (katër miliardë e treqind e dyzet e shtatë milionë e shtatëqind e pesëdhjetë e tre mijë e dyqind e njëzet e tre) lekë;

ii. Bashkisë Tiranë, në vlerën, gjithsej 5 184 188 593 (pesë miliardë e njëqind e tetëdhjetë e katër milionë e njëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e tre) lekë.

2. Fondi që do të përdoret, i miratuar në buxhetin e vitit 2020, do të jetë 7 292 186 370 (shtatë miliardë e dyqind e nëntëdhjetë e dy milionë e njëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e shtatëdhjetë) lekë pa TVSH, nga të cilat:

i. Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2020, në zërin “Shpenzime kapitale me financim të brendshëm”, të programit 06210 “Programe zhvillimi”, i shtohet fondi prej 4 347 753 223 (katër miliardë e treqind e dyzet e shtatë milionë e shtatëqind e pesëdhjetë e tre mijë e dyqind e njëzet e tre) lekë pa TVSH.

ii. Bashkisë Tiranë i transferohet fondi prej 2 944 433 147 (dy miliardë e nëntëqind e dyzet e katër milionë e katërqind e tridhjetë e tre mijë e njëqind e dyzet e shtatë) lekësh, në formën e transfertës së pakushtëzuar.

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe